



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:093975  
Datë: 07.05.2024  
Numri i dokumentit: 05661111

**C.nr. 2159/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florian Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K.D. të cilin e përfaqëson avokat E.O, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies sociale, me objekt kontesti: pagesën të ardhurave personale, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, me datë 17.04.2024 mori dhe me datë 07.05.2024 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET** në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit K.D., me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale që paditësit në emër të kompensimit të pagesës si kujdestar i personit tetraplegjik, për periudhën nga data 30.06.2017 deri me datë 30.11.2020, t'ia paguajë për çdo muaj shumën prej 275 euro, apo shumën totale prej 11,275.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë në Gjykatë, e deri në pagesën definitive.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka paraqitur padi në këtë gjykatë me objekt kontesti kompensimin e pagesës së pensionit si kujdestar i personit tetraplegjik dhe paraplegjik. Në padi ndër të tjera ka theksuar se, paditësi është caktuar si kujdestar i gjyshes së tij B.D., sipas deklaratës noteriale me LRP.nr. 8777/2019, pasi që e njëjta është me aftësi të kufizuara. Tutje ka theksuar se sipas aktgjykimit A.nr. 1119/18 i datës 26.11.2020, i plotësuar me aktvendimin A.nr. 1119/18, datë 02.02.2021 B.D. i është njohur e drejta që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Pensioneve, t'ia kompensojë pagesat në mënyrë retroaktive në emër të të drejtës në kompensim për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, të grupit të parë, si dhe për kujdestar në shumën e cila aplikohet për këtë lloj të pensionit dhe atë për periudhën 5 vjeçare deri me datën 30.11.2025. Ka shtuar se paditësi është kujdesur për gjyshen e tij, që nga vitit 2017, duke i mbrojtur interesat e saj pasurore dhe personale me shpenzimet e tij, kjo sipas deklaratës nën betim para organit noterial, dhe duke qenë se në bazë të ligjit për statusin dhe të drejtat e personave tetraplegjik dhe paraplegjik, neni 9, kujdestarit i takon shuma e njëjtë si përfituesi, pasi që paditësi në cilësinë e kujdestarit

nuk i janë llogaritur në mënyrë retroaktive pagesat si kujdestar për periudhën 30.06.2020 si përfitues.

Në seancë dëgjimore përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se, në procedurë përmbartimore përmbartimi i shumës së pensionit si kujdestar është bërë vetëm sa i përket personit të cilit i është ofruar përkujujesja (gjyshes së paditësit) ndërsa nuk është përmbartuar shuma që i takon paditësit si kujdestar sipas vendimeve në procedurë administrative. Ka shtuar se nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës pasi që e drejta e paditësit buron nga një vendim i gjykatës i formës së prerë dhe për kërkesat e tilla zbatohet afati i parashkrimit prej 10 viteve, ndërsa për të drejtën e paditësit sipas padisë ekziston baza e mjaftueshme ligjore. Ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e paditurës se mes kujdestarit dhe personit tetraplegjik dhe paraplegjik duhet të ekzistojë një marrëveshje, sepse nënshkrimi i kësaj marrëveshje ka qenë i pamundur ngase gjyshja e paditësit nuk ka qenë në gjendje të lidhë punë juridike të vlefshme. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura me përgjigje në padi ka theksuar se, lidhur me të njëjtën çështje juridike paditësi ka iniciuar procedurë gjyqësore në departamentin për çështje administrative dhe lënda ka marrë numrin A.nr. 1119/18, i plotësuar me aktvendimin nr. 1119/18, datë 02.02.2021, dhe se me të njëjtin aktgjykim paditësi ka iniciuar procedurë përmbartimore ku përmbartuesi privat ka bërë ekzekutimin e urdhrin përmbartimor P.nr. 1021/21 në vlerën prej 13,825.00 euro dhe përmbartuesi privat pas ekzekutimit ka lëshuar urdhrin për përfundimin e procedurës përmbartimore. Ka shtuar se meqenëse kjo çështje është e gjykuar padia duhet të hedhet si e palejueshme. Në seanca gjyqësore përfaqësuesi i të paditurës ka deklaruar se, çështja kontestuese është më shumë çështje administrative, dhe se paditësi ka anashkaluar veprimet të cilat ka qenë i obliguar që ti ndërmarrë konform nenit 8 paragrafi 5 të ligjit për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, ku përcaktohet se përfituesi duhet të deklarojë emrin e kujdestarit personal para organit kompetent që regjistron pastaj kujdestarin në një regjistër të posaçëm së bashku me Kontratën e vërtetuar tek noteri. Ka theksuar se akti noterial i bashkëngjitur si provë LRP.nr. 8770/2019 i datës 11.07.2019 nuk përbën Kontratë e cilat kërkohet sipas nenit 8 të ligjit të lartë cituar dhe se aktgjykimi i nxjerrë në procedurë administrative dhe aktvendimi plotësues nuk e obligon të paditurën që paditësin ta kompensojë në emër të këtij përfitimi për arsye se as për gjykatën nuk ka qenë e qartë se kush është kujdestari i të ndjerës (gjyshes së paditësit). Ka shtuar se kërkesëpadia e paditësit është po ashtu e parashkruar sipas LMD-së, duke pasur parasysh që paditësi padinë e ka dorëzuar me datë 10.05.2021, ndërsa kërkon kompensimin nga data 30.06.2017 deri me datë 25.07.2021 dhe se aktgjykimi i nxjerrë në procedurë administrative ka të bëjë vetëm me kërkesëpadinë e gjyshes së paditësit (tani e ndjerë) e cila ka të bëjë me anulimin e aktvendimit për njohjen e të drejtës për personat tetraplegjik dhe paraplegjik dhe se deklarata noteriale e paditësit ka të bëjë vetëm me deklarimin e paditësit se është nip i të ndjerës dhe e njëjta deklaratë shërben vetëm për aplikim të statusit të kujdestarit të të ndjerës. Si përfundim ka theksuar se meqenëse paditësi nuk ka respektuar procedurat administrative për njohjen e të drejtës si kujdestar, kërkesëpadia e paditësit duhet të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata ka zhvilluar procedurën e të provuarit, dhe me propozimin e palëve ndërgjyqëse ka

administruar provat si në vijim: Akti i pranuar nën betim, LRP.nr. 8770/2019, Aktvendimi A.nr. 1119/18, datë 02.02.2021, Aktgjykimi A.nr. 1119/18, datë 26.11.2020, Raportet Mjekësore të QKUK-së, pasqyra e shpenzimeve e datës 27.09.2021, fatura e shpenzimeve përmbartimore e datës 24.09.2021, Urdhër përmbartimor, P.nr. 1021/21, i datës 24.09.2021, ekspertiza financiare e datës 27.02.2024, deklaratë e përbashkët e bashkësisë familjare, e datës 08.01.2015, komunikimet elektronike me datë të printimit 20.02.2024, Vendimi i datës 14.12.2017, Kërkesa për qasje në dokumente publike, certifikata e vdekjes e datës 14.10.2021, certifikata e vdekjes V10246618, Aktvendimi LRP.nr. 6983/2021, Ref. Nr. 1600/2021, e datës 08.12.2021, Propozim për përmbartim, nr. 36/2021, Konkluzion për transfer.

Pas vlerësimi të të gjitha provave një nga një dhe të gjitha së bashku, konform nenit 8 të LPK-së, gjykata erdhi në përfundimin dhe vlerësimin se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Bazuar në deklaratimet e palëve dhe provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, gjykata gjen se ndërmjet palëve ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore nuk ishte kontestuese se paditësi kishte qenë nipi i të ndjerës gjyshes së tij B.D.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishin faktet, nëse paditësi kishte qenë i regjistruar si kujdestar i gjyshes së tij, dhe nëse paditësit i është krijuar baza ligjore për të kërkuar në mënyrë retroaktive pensionin si kujdestar i gjyshes së tij për periudhën kontestuese si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë procedurës gjyqësore nga të gjitha provat dhe deklaratimet e palëve është arritur të vërtetohet se gjyshja e paditësit, B.D. kishte qenë person me status tetraplegjik dhe paraplegjik, dhe bazuar në Ligjin Nr. 05/L -067 për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, e njëjta kishte aplikuar për pensionin i cili ju takon kësaj kategorie të personave sipas këtij ligji, mirëpo zyra e pensioneve pranë të të paditurës kishte refuzuar kërkesën e B.D. për kompensimin e pensionit të kësaj kategorie me konstatimin se nuk ishin plotësuar kushtet ligjore, fakt ky i cili vërtetohet sipas Vendimit të datës 14.12.2017.

Nga provat e administruara vërtetohet se B.D. kishte atakuar vendimin për refuzimin e njohjes së pensionit, pranë Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin A.nr. 1119/18, datë 26.11.2020, kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e B.D., kishte anuluar vendimin e të paditurës 14.12.2017 dhe e kishte obliguar të paditurën që gjyshes së paditësit B.D. t'ia paguante nga data 30.06.2017 deri me datë 30.06.2017 shumën për çdo muaj nga 375 euro në muaj. Ndërsa me Aktvendimin korrigjues A.nr. 1119/18, datë 02.02.2021, Departamenti për Çështje Administrative pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë kishte bërë përmirësimin e aktgjykimit bazë, ashtu që e kishte obliguar të paditurën që t'ia paguante gjyshes së paditësit çdo muaj nga data 30.06.2017 deri me datë 30.11.2020 shumën prej 275 euro në muaj, si dhe t'ia paguante nga data 01.12.2020 shumën e njëjtë në emër të pensionit të ardhshëm, si dhe pensionin për kujdestar në shumën e cila aplikohet për këtë lloj të pensionit për pesë vite, pra nga data 01.12.2020 deri me datë 30.11.2025.

Nga propozimi për përmbarrim nr. 1634/2021, i datës 03.2021 vërtetohet fakti se me qëllim të përmbarrimit të shumave të njohura sipas aktgjykimit dhe aktvendimit të lartë cituar, këtu paditësi në emrin e tij dhe në emrin e gjyshes së tij, kishte iniciuar procedurë përmbarrimore, ndërsa përmbarruesi privat kishte nxjerrë urdhrin 1021/21 të datës 04.06.2021 sipas të cilit ishin përmbarruar shuma bazë prej 13,825 euro, së bashku me kamatë ligjore dhe shpenzimet e tjera të procedurës përmbarrimore, fakt ky i cili vërtetohet sipas konkluzionit të përmbarruesit privat I.G. Sipas vet propozimit për përmbarrim shihet se në këtë propozim shuma prej 11,275.00 euro ishte kërkuar që të përmbarronohet në emër të gjyshes së paditësit, ndërsa shuma tjetër e mbetur ishte përmbarruar në emër të kompensimit që i takonte paditësit si kujdestar i gjyshes së tij, dhe atë siç është theksuar në propozim për përmbarrim, për periudhën e arritur për pagesë nga data 01.12.2020 deri me 31.05.2021.

Nga vërtetimi i gjendjes faktike si më lartë, rezulton se paditësi përmes paditësi ka kërkuar që të obligohet e paditura që t'ia paguajë në mënyrë retroaktive, për çdo muaj nga 275 euro për çdo muaj, nga data 30.06.2017 deri me datë 30.11.2020, në emër të pensionit që të njëjtit i takonte si kujdestar i gjyshes së tij. Në këtë kuptim gjykata fillimisht sjell në vëmendje se sa i përket kompetencës së gjykatës, ndonëse nga e paditura është paraqitur prapësimi procedural se çështja në fjalë është çështje administrative dhe po ashtu nga e paditura është pretenduar se çështja në fjalë përbën çështje të gjykuar ngase për të njëjtën çështje paditësi po ashtu ka iniciuar konflikt administrativ i cili është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë, megjithatë sipas vlerësimit të kësaj gjykate, ndonëse qëndron fakti se çështja e njohjes së pensioneve është në kompetencë të Departamentit për Çështje Administrative, megjithatë në rastin konkret padia e paditësit ka të bëjë me obligimin e të paditurës që t'ia paguajë shumën e pensionit, e cila sipas pretendimit të paditësit i është njohur nga Departamenti për Çështje Administrative, që paraqet pikërisht çështje juridike civile (padi detyrimi) e cila duhet të gjykohet pranë departamentit të përgjithshëm. Ndërsa edhe sa i përket pretendimit për çështje të gjykuar, po ashtu gjykata e gjeti të pabazuar, ngase në procedurë administrative si palë ka qenë gjyshja e paditësit, e cila kishte kërkuar njohjen e të drejtës së saj në pension, dhe njohjen e pensionit për kujdestar që kujdeset për të, ndërsa sipas padisë së gjykuar me këtë aktgjykim, paditësi është K.D., dhe objekt i kontestit është detyrimi për përmbushje të obligimit i cili sipas pretendimit të paditësit i është njohur në procedurë administrative.

Pavarësisht të thënave si më lartë sa i përket kompetencës dhe çështjes së gjykuar, gjykata pas vlerësimit të provave, vërtetimit të gjendjes faktike dhe deklarimeve të palëve, erdhi në përfundimin se kërkesëpadija e paditësit është në tërësi e pabazuar. Kjo për faktin se në procedurë gjyqësore me asnjë nga provat e administruara nuk është provuar se e paditura ka për obligim që paditësit t'ia paguajë shumën e kërkuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Paditësi me padi, dhe gjatë seancave gjyqësore ka pretenduar se i njëjti është kujdesur për gjyshen e tij që nga viti 2017, andaj të njëjtit i takon pensioni i kujdestarit i cili nga e paditura nuk është paguar për periudhën retroaktive nga data 30.06.2017 deri me datë 30.11.2020. Në këtë kuptim gjykata fillimisht sjell në vëmendje nenin 8 të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, i cili përcakton: *1. Përfituesve të këtij ligji u njihet e*

*drejta për një kujdestar personal, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, me qëllim të ofrimit të kujdesit dhe shërbimeve të domosdoshme ditore, e të cilët kompensohen në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e këtij ligji. 2. Përfituesit e këtij ligji kanë të drejtën e zgjedhjes së kujdestarit të tyre. 3. Nëse përfituesi i këtij ligji nuk është në gjendje të bëjë zgjedhjen e kujdestarit, organi i kujdestarisë i cakton kujdestarin. 4. Përfituesit e këtij ligji nënshkruajnë kontratë me kujdestarin e tyre, para organit kompetent të Noterisë. 5. Përfituesit e këtij ligji, duhet të deklarojë emrin e kujdestarit personal, para organit kompetent që e regjistron atë në një regjistër të posaçëm së bashku me kontratën e vërtetuar tek Noteri. Bazuar në këtë dispozitë ligjore, rezulton se personi që gëzon statusin e personit tetraplegjik ose paraplegjik gëzon të drejtën për kujdestar personal, dhe po ashtu me paragrafin 1 të dispozitës së lartë cituar përcaktohet se edhe kujdestareve të personave tetraplegjik dhe paraplegjik iu takon e drejta në kompensim, në shumën e njëjtë sikurse përfituesit e përkujdesjes. Në paragrafin 5 të dispozitës së lartë cituar, përcaktohet se personat tetraplegjik dhe paraplegjik duhet të deklarojnë emrin e kujdestarit personal tek organi kompetent së bashku me Kontratën e vërtetuar tek noteri, dhe kujdestari duhet të regjistrohet në regjistër të veçantë.*

Bazuar në interpretimin si më lartë, rezulton se paditësi nuk ka përmbushur asnjërin nga kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitën e lartë cituar. Kjo për faktin se paditësi nuk ka argumentuar me prova fillimisht se i njëjti ka pasur Kontratë të nënshkruar pranë noterit së bashku me gjyshen e tij, përmes të cilës do të argumentonte se i njëjti ka qenë i caktuar si kujdestar i të njëjtës. Paditësi si provë ka paraqitur Aktin e pranuar nën betim, LRP.nr. 8770/2019, megjithatë nga deklarata në fjalë shihet se e njëjta është dhënë pranë noterit kompetent nga vet paditësi dhe kjo deklaratë përmban vetëm deklaratimet e paditësit dhe nënshkrimin e tij, ndërsa në deklaratë nuk ka asnjë deklaram dhe/ose konfirmim të personit përfitues të përkujdesjes (gjyshes së paditësit) me të cilën e konfirmon se e ka caktuar paditësin si kujdestar të tij. Për më tepër, paditësi me asnjë provë nuk e ka argumentuar që i njëjti ka qenë i regjistruar si kujdestar i gjyshes së tij në regjistrat e veçantë të të paditurës, siç kërkohet nga paragrafi 5 i nenit 8 të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Tetraplegjik dhe Paraplegjik. Sipas këtyre konstatimeve, paditësi nuk ka përfillur procedurat ligjore që i njëjti të regjistrohet si kujdestar i gjyshes së tij në regjistrat e veçantë, e që pastaj të derivonte obligimi i të paditurës për pagesën e pensionit.

Në funksion të vërtetimit të gjendjes faktike, duke u bazuar në faktin se paditësi ka kërkuar që në mënyrë retroaktive ti paguhet kompensimi në emër të pensionit si kujdestar, sipas vendimit të Gjykatës me A.nr.1119/2020, datë 26.11.2020, si dhe Aktvendimit 1119/2020 datë 02.02.2021, megjithatë gjykata sjell në vëmendje se sipas aktgjykimit dhe aktvendimit në fjalë, palë paditëse ka qenë gjyshja e paditësit B.D., të cilës sipas vendimeve në fjalë i është njohur e drejta në pension personal si dhe në pensionin për kujdestar, megjithatë as në aktgjykim e as në aktvendimin e lartë cituar të departamentit administrativ nuk ceket se këtu paditësi është i caktuar si kujdestar i të njëjtës, gjegjësisht gjyshes së paditësit i është njohur e drejta për pensionin e kujdestarit që kujdeset për të, por nuk është përcaktuar se kush është kujdestari. Për më tepër, gjykata sjell në vëmendje se edhe sikur të ishte caktuar paditësi si kujdestar me aktgjykimin dhe aktvendimin korrigjues të Departamentit Administrativ, nga Aktvendimi i Departamentit Administrativ shihet se gjyshes së paditësit i është njohur e drejta për pensionin për kujdestar që

nga data 01.12.2020 dhe për pesë vitet e ardhshme, ndërsa paditësi ka kërkuar kompensimin në mënyrë retroaktive nga data 30.06.2017 deri me datë 30.11.2020, çka rezulton se edhe në një situatë të tillë kërkesëpadia e paditësit do të ishte e pabazuar, ngase pensioni për kujdestar sipas vendimit të Gjykatës Administrative është njohur nga data 30.11.2020 dhe për pesë vite të tjera në të ardhmen, dhe jo në mënyrë retroaktive siç është kërkuar nga pala paditëse.

Bazuar në të gjitha të lartë cekurat, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit për obligimin e të paditurës për pagesën e pensionit si kujdestar i gjyshes së tij është e pabazuar, për faktin se nga vërtetimi i gjendjes faktike dhe nga provat e administruara, nuk del themelësia e kërkesëpadiës, që e paditura të ketë obligim për pagesën e detyrimit në fjalë për paditësin.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi duke u bazuar në nenin Neni 450 të LPK-së, e cila përcakton: *Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.*

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, bazuar në nenin 160 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. 2159/2021, datë 07.05.2024

**Gjyqtari**  
**Florian Krasniqi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.